



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.5.2023

Nr: 526

Ora: 14:20

V E N D I M

P Ë R

MBYLLJEN E ZYRAVE ZGJEDHORE TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË"
DHE SUBJEKTIT ZGJEDHOR KOALICIONI "BASHKË FITOJMË", NË BASHKINË TIRANË

Sot më datë 14 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim informacionin e përcjellë nga monitoruesi, me:

OBJEKT: Identifikim i zyrave zgjedhore të subjekteve zgjedhore "Partia Socialiste e Shqipërisë" dhe Koalicioni "Bashkë Fitojmë" afër QV-ve dhe KZAZ-ve, Bashkia Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datë 14.05.2023 janë administruar raportet e dërguara nga monitoruesit e caktuar për Bashkinë Tiranë.

Nëpërmjet këtyre raporteve identifikohen zyra zgjedhore të hapura afër QV-ve dhe KZAZ-ve, në distancë më të vogël se 300 m, përkatësisht:

- Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", afër QV-së nr. 2102 me vendndodhje në Shkollën 9 vjeçare "Marvete Peza", Pezë Helmes.

Data: 14.5.2023 Nr: 526
Ora: 14:20



"Për mbylljen e zyrave zgjedhore të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" dhe subjektit zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë", në Bashkinë Tiranë"

- Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, afër KZAZ-së nr. 29, me vendndodhje në Kashar. Me vendimin nr. 497, datë 11.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka urdhëruar mbylljen e kesaj zyre zgjedhore. Nga informacioni i monitoruesit në datën 14 maj 2023, rezulton se kjo zyrë vazhdon të jetë e hapur.
- Subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, afër QV-ve nr. 1822/00, 1823/00, me vendndodhje në Rrugën “Milto Tutulani”, tek Fakulteti i Drejtësisë, edhe pse është marrë vendim për mbylljen e kësaj zyre, rezulton të jetë përsëri e hapur. Me vendimin nr. 452, datë 06.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka urdhëruar mbylljen e kesaj zyre zgjedhore. Nga informacioni i monitoruesit në datën 14 maj 2023, rezulton se kjo zyrë vazhdon të jetë e hapur.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” të mbyllë menjëherë zyrat zgjedhore afër QV-së nr. 2102 me vendndodhje, Shkolla 9 vjeçare “Marvete Peza”, Pezë Helmes dhe KZAZ-së nr. 29 me vendndodhje në Kashar.
2. Urdhërimin e subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, të mbyllë menjëherë zyrën zgjedhore afër QV-ve nr. 1822/00, 1823/00, me vendndodhje në Rrugën “Milto Tutulani”, tek Fakulteti i Drejtësisë.
3. Urdhërimin e Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake, të mbyllin menjëherë zyrat zgjedhore të caktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Ngarkohen subjektet zgjedhore, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Tiranë për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
5. Ky vendim t’u njoftohet menjëherë subjekteve zgjedhore, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI